



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:064564

Datë: 06.03.2024

Numri i dokumentit: 05416909

**P.nr.175/2023**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunëtoren profesionale Shqipe Latifi, ne çështjen penale ndaj të akuzuarit G... R... nga fshati G..., Komuna e P..., për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 323 paragrafi 1 KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.246/2023 të datës 07.03.2023, të cilën e përfaqëson prokurori i shtetit Ilirjana Haziri - Kryeziu, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 28.02.2024, publikisht shpalli, ndërsa më 05.03.2024, hartoi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari **G... R...** nga i ati B..., e ëma Xh..., e lindur D..., i lindur ...në f.sh. Gllamnik, K. Podujevës ku edhe jeton, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor ne ndërtimtari, me gjendje të mesme ekonomike, me nr. Perso..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë.

### **Është fajtor**

**Sepse** gjatë muajit Nëntor - Dhjetor të vitit 2020 , në Prishtinë , i akuzuari Gazmend Rexhepi , me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete , duke e përdorur metodën e mashtrimit , me dashje sjell në lajthim personin tjetër edhe atë të dëmtuarin Agim Selimi, si blerës i fundit i veturës, në atë mënyrë që në automjetin e tij të markës Wolkswagen – VW GOLF VII ,ngjyrë e zezë, prodhim i vitit 2013, me numër NIA:WVWZZZAUZDP084236, ka zbritur kilometrat në odometër për 84.619 km, e më pas të njëjtin ia ka shitur Visar Thaquit , i cili më pas veturën ia shet tani të dëmtuarit Agim Selimi , duke e fshehur këtë fakt e i cili ka ndikuar në vlerën e veturës, kështu që i akuzuari me veprimet e tij e ka shtytë të dëmtuarin Agim Selimi të veprojë në dëm të pasurisë së tij , e duke krijuar dobi pasurore për vete.

-Me çka ka kryer veprën penale, **Mashtrimi, nga neni 323 paragrafi 1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore si dhe neneve, 4,7,17,38,39,40,43,44 69,70,71 dhe 72 dhe 323 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 452 të KPPRK-ës,

## E D Ë N O N

Të akuzuarit **G... R...**, me gjobë në shumë prej **500 €**, (pesëqind euro) dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej **150 (njëqind e pesëdhjetë) ditëve** ashtu që me propozimin dhe me pëlqimin e të akuzuarit si dhe në kuptim të nenit **44 të KPRK-së**, të akuzuarit dënimi i shqiptuar me burgim i **ZËVENDËSOHET** me dënim me gjobë në shumën prej **2200 € (dymijë e dyqind - euro)**, ashtu që i akuzuari gjobën në shumë të përgjithshme **2700 € (dymijë e shtatëqind euro)** është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditëve nga dita pasuese pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguajë dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që 1 (një) ditë burgim do t'i llogaritet për çdo 20 euro, të dënimit me gjobë.

Pala e dëmtuar A...S... për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 30 € (tridhjetë) euro, si dhe 20 € (njëzet) euro për kompensimin e viktimave të krimit dhe shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës.

## A r s y e t i m

### 1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, me datë 07.03.2023 ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.246/2023, kundër të pandehurit G... R... nga fshati G..., Komuna e P., për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 323 paragrafi 1 KPRK-së.

Ndërsa më datën 13.03.2023 Prokuroria Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm ka dorëzuar Marrëveshjen për pranimit të fajësisë të lidhur në Prokurori ndërmjet Prokurorisë dhe të akuzuarit me mbrojtësin e tij.

Më datë 28.02.2024, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestare dhe publike në të cilën seancë prezent Prokurorja e Shtetit Ilirjana Haziri - Kryeziu , i akuzuari Gazmend Rexhepi me mbrojtësin e tij sipas autorizimit Amir Rudaku, ku në këtë seancë gjyqtari i vetëm gjykues ka marr Aktvendim për Refuzim të marrëveshjes së pranimit të fajësisë të lidhur në prokurori, me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore, konform nenit 230 të KPPK-ës, ndërsa në këtë seancë i akuzuari pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, deklarohet se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale.

## 2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i akuzuari Gazmend Rexhepi nga fshati Gllamnik, Komuna e Podujevës, për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 323 paragrafi 1 KPRK-së, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## 4. Elementet e veprës penale

*Në bazë të nenin 323 të KPRK-s, sa i përket veprës penale mashtrimi, parashihet:*

*1. Kushdo që me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke fshehur faktet ose në çfarëdo mënyre tjetër mashtruese dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo personin tjetër, ose për t'i shkaktuar dëm material personit tjetër, e mashtron apo vazhdon lajthimin e personit tjetër dhe me këtë e nxit një person që të kryej apo të mos kryej një veprim, i cili rezulton në dëm material të pasurisë së tij/saj apo të pasurisë së personit tjetër ose rezulton në dobi pasurore të kundërligjshme, për veten apo personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.*

## 5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se të pandehurit Gazmend Rexhepi, t'i shqiptohet dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën, janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë një dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit e të pandehurit, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 69 dhe 71 të KPRK-së, Kështu, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin dhe ndaj të pandehurit ka shqiptuar dënim nën minimumin e posaçëm, është fakti se i akuzuari ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin. Ndërsa si rrethanë rënduese pati

parasysh shkallen e përgjegjësisë penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale.

**6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar**

Gjykata, ka konstatuar se me dënim me gjobë mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

**7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale**

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nën 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor, si dhe denimin prej tridhjet eurove për mbrojtjen e viktimave të krimit, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.175/2023 i dt.05.03.2024**

**Gjyqtari vetëm gjykues,  
Veli KRYEZIU**

**KËSHILLA JURIDIKE** :Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të Përgjithshëm në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.